



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Nr. 03 /2026

Datë: 29/01/2026

Në mbështetje të nenit 21, paragrafi 2, 3 dhe 4, nenit 23 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, dhe nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve nxjerr këtë:

V E N D I M *Nr: 03/2026*

1. Afati për lëshimin e faturave të tatimit në pronë shtyhet deri më **31 Mars 2026**.
2. Afati për pagimin e kështit të parë të detyrimeve të tatimit në pronë shtyhet deri në **30 Qershor 2026**.
3. Obligohen Departamenti i Tatimit në Pronë dhe Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Zyrat e Tatimit në Pronë në Komuna për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M I

Në mbështetje të mbrojtjes së interesit të tatimpaguesve dhe garantimit të administrimit të drejtë dhe të ligjshëm të tatimit në pronë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka vlerësuar të domosdoshme shtyrjen e afatit për lëshimin e faturave të tatimit në pronë për vitin tatimor 2026. Kjo masë është marrë në zbatim të nenit 14 par. 2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, sipas të cilit regjistrat e tatimit në pronë bazohen në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Gjatë procesit të përditësimit të këtyre regjistrave, janë konstatuar ndryshime në kufijtë e zonave kadastrale, të cilat prekin dy apo më shumë komuna. Këto ndryshime, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve i ka vërejtur me vonesë, gjë që ka shkaktuar pamundësimin e përkohshëm të reflektimit të saktë të të dhënave grafike dhe tekstuale kadastrale në regjistrat e tatimit në pronë. Në këto rrethana, ky veprim ndërmerret për të shmangur lëshimin e faturave të tatimit në pronë me vlerësim tatimor në shpërputhje me të dhënat kadastrale.

Në këtë kontekst, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve thekson se shtyrja e lëshimit të faturave ndërlidhet edhe me shtyrjen e zbatimit të shkallës progresive për tatimin në pronë sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L005, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-224. Zbatimi, apo shtyrja e mundshme e shkallës progresive për tatimin në pronë është e lidhur ngushtë me parashikimet në Ligjin për Ndarjet Buxhetore, i

cili për vitin 2026 nuk është miratuar ende. Për shkak se vazhdimi i aplikimit të shkallës tatimore tranzitore ndikon drejtpërdrejt në mënyrën dhe masën e përlogaritjes së tatimit në pronë, si dhe duke pasur parasysh nevojën për siguri juridike, parashikueshmëri fiskale dhe pritshmëri legjitime Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka vendosur që shtyrja e lëshimit të faturave të tatimit në pronë të marrë në konsideratë gjithashtu edhe parashikimet ligjore në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Iu dërgohet:

- *Të gjitha Komunave;*
- *Departamentit të Tatimit në Pronë;*
- *Departamentit për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së; dhe*
- *Arkivit të MFPT-së.*